



KUVENDI I KOMUNËS **KOMITETI PËR KOMUNITETE**

Procesverbal nga mbledhja e XXXI-të (tridhjetenjë - mandati VII), e Komitetit për Komunitete, e mbajtur më 05 mars 2025

Mbledhja u mbajt në sallën e mbledhjeve të Kuvendit, dhe filloi në orën 11:05

Mbledhjen e hapi dhe e kryesoi z.Xhafer Ademi Kryesues i Komitetit për Komunitete.

Fillimisht u vërtetua se në mbledhje të pranishëm ishin anëtarët e këtij Komiteti dhe atë: znj.Qëndresë Hajrizi, z.Florent Hasani, z.Demokrat Hodolli, z.Arbnor Fazliu, znj.Shkurte Sejdiu, znj.Sevdije Mustafa, znj.Fikmete Qurkolli, ndërsa mungoi z.Selver Rama.

Me këtë u konstatua se ekziston kuorumi për punë.

Në mbledhje të pranishëm tjerë ishin: z.Liman Zeqiri shef i Zyrës Komunale për Komunitete dhe Kthim-ZKKK; znj.Arbresha Bashota zyrtare në Drejtorinë e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale DSHMS në Komunën e Podujevës; z.Driton Shabani nga Stacioni i Policisë në Podujevë, përfaqësues nga KFOR OF2 Kovacs dhe OR5 Kucsera.

Rendi i ditës

z.Xhafer Ademi, Kryesues i Komitetit, e hapi mbledhjen duke përshëndetur të pranishmit, theksoi, thirrja dhe materiali për këtë mbledhje besoj ju është dërguar me kohë.

Në vazhdim lexon rendin e ditës dhe pyet nëse ndokush dëshiron fjalën rreth rendit të ditës, nëse jo atëherë e hedh në votim.

Njëzëri me 8 vota Për nga anëtarët/et e Komitetit sa ishin prezent në sallë, miratohet rendi i propozuar i ditës sipas thirrjes dhe materialit përkatës të dërguar me thirrjen e kësaj mbledhje.

1. Procesverbali nga mbledhja e Komitetit për Komunitete e mbajtur më 05.02.2025

Kryesuesi i Komitetit, theksoi, urdhëroni nëse ndokush dëshiron fjalën për ndonjë plotësim ndryshim apo vërejtje eventuale në këtë procesverbal nga mbledhja e kaluar, nëse jo e hedh në votim ashtu siç ju është përcjellë.

Pas votimit u konstatua se Njëzëri me 8 vota Për, nga anëtarët e Komitetit sa ishin në sallë, miratohet procesverbali nga mbledhja e Komitetit për Komunitete nga mbledhja e datës 05 shkurt 2025, dhe atë sipas materialit të dërguar me thirrjen e mbledhjes.

2. Informatë e Drejtorisë së Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale – Sektori i Strehimit dhe Banimit, rreth gjendjes sociale-ekonomike të Komuniteteve jo shumicë, me theks të veçantë gjendja së banimit.

Kryesuesi i Komitetit, theksoi, pasi që zyrtarja nga kjo Drejtoria është prezentë, ja japim fjalën.

znj.Arbresha Bashota, zyrtare në DSHMS, e paraqiti Informatën në fjalë rreth kësaj pike të rendit të ditës, theksoi, gjithherë në Drejtorin ton kemi kërkesa për strehim, për ndërtim dhe për renovim të shtëpive, por duke pasur parasysh që buxhetin e kemi të limituar për këto çështje, ne i vizitojmë, marrim shënime dhe diskutojmë me donatorët edhe pastaj i procedojmë nëse kemi ndihmë nga donatorët. Kemi financimin që tani është kompletuar ndërtimi i shtëpisë së një familje të komunitetit jo shumicë z.Veli Halili të cilit çelësat e shtëpisë ende nuk ju kanë dhënë por pritet që gjatë muajit të Ramazanit bashkërisht me Shoqatën përkatëse t’ia dorëzojmë çelësat e shtëpisë e cila i është ndërtuar dhe është e mobiluar me gjëra të reja.

Po ashtu jemi në pritje të projektit për efikasitet që të shpallet thirrja publike nga ana e Ministrisë dhe t’i ndihmojmë për aplikim lidhur me renovimin e shtëpive dhe izolimin e kulmeve të shtëpive. Po ashtu DSHMS ndihmon me subvencionim të barnave edhe perona të komunitetit jo shumicë ku kemi kërkesa për ndihmë për subvencionim të barnave për rastet sociale e që i kemi ndihmuar disa. Përveç kësaj në muajin e Ramazanit kemi dhe donacione me pako ushqimore, ku jemi duke shpërndarë pako të tilla ushqimore dhe gjithmonë i kemi parasysh edhe familjet e komunitetit jo shumicë duke pasur parasysh në çfarë gjendje ekonomike jetojnë sepse jemi në dijeni në bazë të vizitave që bëjmë dhe e dimë gjendjen e tyre, prandaj jemi duke bërë përpjeke për t’iu ndihmuar sa më shumë të jetë e mundur, projekti i cili është duke vazhduar sepse kemi gjatë muajit të Ramazanit kemi donatorë të ndryshëm e që vetëm ditëve të fundit jemi në pritje të 100 pakove ku sigurisht se do të përfshihen edhe familjet e komunitetit jo shumicë e të cilat gjithmonë do t’i kemi parasysh dhe do t’i përfshijmë në këto ndihma.

Kryesuesi i Komitetit, pyetje parafolëses, se a ka ndonjë donator të ri për ndërtimin e shtëpive.

znj.Arbresha Bashota, zyrtare në DSHMS, përgjigje parafolësit, theksoi, momentalisht jo nuk kemi ndonjë donator të tillë, por ne e kemi një Marrëveshje me Shoqatën “Jetimat e Ballkanit”, për ndërtimin e 5 shtëpive dhe një ndër ato është edhe familja nga komuniteti jo shumicë.

Pastaj ne si komunë e kemi dorëzuar kërkesën në Ministrinë përkatëse për projektin që përmban 3 fusha, or që kërkesa jonë është për 2 fusha, njëra ka të bëjë me ndërtimet e shtëpive dhe tjetra ka të bëjë me riparimet apo rinovimet e shtëpive, pra e kemi plotësuar të gjithë dokumentacionin dhe e kemi dërguar në Ministri, jemi përzgjedhur si Komunë që do të na ndihmojnë dhe tani jemi duke pritur kur do të bëhet shpallja dhe deri sa të përfundojnë procedurat përkatëse nga ana e Ministrisë ku pastaj është pjesa jonë si Komunë, por që se si do të bëhen aplikimet a do bëhen këtu në Komunë apo përmes ndonjë platforme online këtë nuk e dimë ende, mirëpo sigurisht që do të ketë marrëveshje Komuna me Ministrinë e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor.

Kryesuesi i Komitetit, theksoi, nëse ka mundësi edhe një herë të na tregoni se si do të informohen komuniteti jo shumicë lidhur me aplikimin në këtë projekt.

znj.Arbresha Bashota, zyrtare në DSHMS, sërish përgjigje parafolësit, theksoi, njoftimet ne do t’i bëjmë përmes ueb faqes së Komunës së Podujevës dhe gjithashtu përmes përfaqësuesve dhe natyrisht do t’i ndihmojnë në plotësimin e aplikacioneve dhe dokumentacioneve të ndryshme sa i përket projektit në fjalë.

Kryesuesi i Komitetit, theksoi, e falënderoj zyrtaren parafolëse për informata e dhëna, urdhëroni nëse ndokush dëshiron fjalën, nëse jo atëherë e konsiderojmë të përfunduar këtë pikë të rendit të ditës.

3. Informatë e Zyrës Komunale për Komunitete dhe Kthim nga Ministria e Punëve të Brendshme për regjistrimin e statusit civil të qytetarëve që nuk kanë qenë të regjistruar deri më tani prej vitit 1999, ku si pasoj nuk disponojnë dokumente personale të republikës së Kosovës

Kryesuesi i Komitetit, theksoi, lidhur me këtë pikë të rendit të ditës fjalën i'a kalojmë shefit të Zyrës Komunale për Komunitete dhe Kthim që të paraqet informatë lidhur me këtë temë.

z.Liman Zeqiri, shëf i ZKKK në Komunën e Podujevës, e paraqiti informatën në fjalë rreth kësaj pike të rendit të ditës, theksoi, ne e dimë që gjatë luftës ka qenë kohë e vështirë dhe shumë njerëz kanë mbetur pa dokumentacione dhe ka ende të tillë që nuk posedojnë letërnjoftim apo mjet identifikimi të cilëve i'u mungon. Për këtë arsyeje Ministria e Punëve të Brendshme ju kanë dërguar një Shkresë të gjithave Zyrave Komunale për Komunitete dhe Kthim, sipas të cilës na kan njoftuar se e kanë bërë të mundur në bazë të të gjitha rrethanave që ka njerëz e sidomos nga komuniteti jo shumicë që nuk po kanë mundësi t'i rregullojnë dokumentacionet që nga muaji qershor 1999. Pra në bazë të Agjencionit për Regjistrim Civil që është në kuadër të MPB, tani qytetarët që nuk kanë dokumente të identifikuese mund t'i dorëzojnë dokumentet dhe të paraqesin kërkesat e tyre për t'u regjistruar dhe për t'u pajisur me ato dokumente.

Këto informata mund t'i marrin edhe nga Qendra e Shërbimit Civil këtu në Podujevë, por edhe nëpërmes Ministrisë së Punëve të Brendshme ku është Agjencioni përkatës, por si proces ka filluar nga 1 shkurti i këtij viti dhe përfundon me 30 prill, andaj do të dëshiroja që t'i informojmë ata njerëz që ne mund të kemi informacione por që më shumë ndoshta mund t'i dini edhe ju si përfaqësues të komuniteteve jo shumicë. Sigurisht që kjo çështje nuk ka të bëjë vetëm me komunitetin jo shumicë por edhe për atë shumicë, andaj është normale që të gjithë të kenë informacionin e duhur dhe ne këtë mund ta plasojmë edhe në ueb faqen zyrtare të Komunës së Podujevës, në mënyrë që ata që nuk kanë dokumentacion të pajisen me dokumente të Republikës së Kosovës, pastaj është procedura tjetër për çka Ministria do të tregoj formën dhe mënyrën e aplikimit, me ndonjë dëshmi apo si do të jetë, prandaj e kam si thirrje që qytetarët të kenë informacione për këtë çështje.

Kryesuesi i Komitetit, theksoi, unë e kam marr këtë informacion dhe i kam edhe dokumentet që më janë dhënë z.Liman Zeqiri, pra ka të bëjnë me thirrje për aplikim dhe për dokumentacion, kështu që gjatë kohës kur i kam marr këto dokumente i kam informuar komunitetin në lagjen ku jetoj unë në rr.“Ali Ajeti” ndërsa për lagjen ku jetojnë komuniteti jo shumicë në rrugën “Xhafer Meta” do të ishte mirë t'i informoj anëtarja e këtij Komiteti përfaqësuese e komunitetit nga ajo lagje znj.Shkurte Sejdiu, ndërsa për fshatra do të kujdesem unë vetë dhe do ti informoj me telefon përfaqësuesit që janë në fshatra dhe do të informohet komuniteti që gjatë kësaj periudhe nëse ka ndonjë prej tyre që nuk është regjistruar, ta bëj tani regjistrimin dhe të pajiset me dokumentet përkatëse identifikuese.

znj.Sevdiye Mustafa, theksoi, mendoj se do të ishte mirë që edhe në rrjetet sociale ta shpërndash këtë informacion ti i nderuar Kryesues si përfaqësues i komunitetit sepse shumë njerëz i marrin informatat nëpërmjet rrjeteve sociale e që shumica e komunitetit jo shumicë të përcjellin ty i nderuar Kryesues në rrjetet sociale.

Kryesuesi i Komitetit, theksoi, nuk e di sa kemi të drejtë të plasojmë këtë gjë në rrejte sociale.

z.Liman Zeqiri, shëf i ZKKK në Komunën e Podujevës, theksoi, mendoj që pasi është dokument zyrtar lejohet dhe nuk paraqet ndonjë problem të plasohet në rrjete sociale sepse kjo ka ardhur si shkresë dhe shumë mirë shkruan aty, pra po e citoj ndër të tjera thuhet “ju lutem që të informoni komunitetet sepse e kanë një afat kohor”, andaj jam i bindur që nuk përbën ndonjë problem sepse është e drejtë e tyre elementare për të pasur dokument identifikimi dhe kjo nuk është një çështje që

ka të bëjë me shkelje të ligjit sepse është dokument zyrtar që është dërguar si shkresë, pra mendoj që edhe në ueb faqen e Komunës së Podujevës do të publikohet ky dokument në mënyrë që informacioni të shpërndalet sa më shumë.

Përveç kësaj, pajtohem me parafolësen që në rrjetet sociale komunikimi tash është më i shpejt dhe informacioni mund të merret më shpejt, pra afati kohor nga 1 shkurt i këtij viti deri me 30 prill të këtij viti, është një afat kohor që të interesuarit mund të informohen dhe në bazë të kësaj mund ta din se ku të orientohen. Pra lidhur me këtë është Agjenica për Regjistrimin Civil që merret me këtë çështje ku përveç kësaj është edhe qendra e shërbimit civil që merret me regjistrimin civil, ku mund të merren informacionet e nevojshme sa i përket kësaj çështje dhe krejt kjo me qëllim të rregullimit të dokumentacionit identifikues apo letërnjoftimit.

Kryesuesi i Komitetit, theksoi, pra afat kemi dhe kush është i interesuar mundet që brenda disa ditëve ose një javë mund të rregulloj atë, andaj kohë ka të mjaftueshme dhe unë do t'i njoftoj edhe nëpërmes rrjeteve sociale me qëllim që komuniteti jo shumicë të informohet sa më mirë.

Urdhëroni nëse ndokush tjetër dëshiron fjalën rreth kësaj çështje, nëse jo e konsideroj të përfunduar edhe këtë pikë të rendit të ditës.

4. Të ndryshme

Kryesuesi i Komitetit, theksoi, dua t'ju informoj që të gjithë punëtorëve të kompanisë “Pastrimi” që i'u pa shkëputur kontrata, tani së fundmi janë pranuar sërish në punë në atë Kompani dhe janë duke punuar. Pra që të gjithë ata punëtor që kanë qenë të larguar, dhe që kan shpreh sërish dëshirë për të punuar aty, janë pranuar dhe i kanë nënshkruar kontratat e reja 1 vjeçare me Kompaninë “Pastrimi”.

Meqë nuk kishte të lajmëruar për të marrë fjalën, Kryesuesi i Komiteti e konstatoj të përfunduar këtë mbledhje.

Mbledhja përfundoi në orën 10:20

**Procesverbalin e mbajti,
Enis Sheholli**

**Nr.Prot.01-01-060/04-0013627/25
Podujevë, 05 mars 2025**

**Kryesuesi i Komitetit
Xhafer Ademi**